

VENDIM
Nr. 542, datë 9.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËS “UNAZA E JASHTME E QYTETIT””, BASHKIA
GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit””, Bashkia Gjirokastrë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Gjirokastrë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 894 (tetëqind e nëntëdhjetë e katër) m², me vlerë të përgjithshme prej 4 349 310 (katër milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 349 310 (katër milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e dhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Gjirokastrë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Gjirokastrë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Gjirokastrë të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë 894 (tetëqind e nëntëdhjetë e katër) m², “truall”, për projektin “Rikonstruksioni i rrugës “Unaza e jashtme e qytetit””, të bëhet në favor të Bashkisë Gjirokastrë.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë dhe Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËS “UNAZA E JASHTME E QYTETIT””, BASHKIA
GJIROKASTËR

Nr.	Emri Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip e truallit/m ²	Çmimi i truallit/lekë	Vlera e përgjithshme /lekë	Lloji i dokumentit
1	Bashkëpronarët Agron Kallfa Bujar Kallfa Manushaqe Kallfa Saide Kallfa Ismail Kallfa	8541	20/24	894	4865	4 349 310	Vërtetim pronësie
	Totali					4 349 310	